

VENDIM
Nr. 71, datë 22.4.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et
“VELESHICA 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5801 kw DHE “VELESHICA 2”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 8116 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR
13917 kw**

(Ndryshuar me vendimin nr. 135, datë 10.8.2020; nr. 222, datë 30.9.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neni 11 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.6.2016; dhe të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 739 prot., datë 13.11.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE, me vendimin nr. 189, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 32/54, datë 24.11.2019 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta.
- Me shkresat nr. 739/1 prot., datë 3.12.2019, nr. 52 prot., datë 14.1.2020 dhe nr. 52/2 prot., datë 27.1.2020, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe i kërkoj plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresat me nr. 52/3 prot., datë 10.2.2020 dhe nr. 52/4 prot., datë 13.2.2020, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të konstatuar në mungesë.
- Në konstatim të mangësive të tjera në dokumentacionin e aplikimit të shoqërisë, së fundmi me shkresën nr. 52/5 prot., datë 10.3.2020, ERE iu drejtua serish shoqërisë, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të munguar e që lidhej me vërtetimet e lëshuara nga prokuroria dhe Gjykata e Rrethit të Tiranës, për shoqërinë dhe administratorin e saj.
- Kontrata e Koncesionit nr. 1605 rep. dhe nr. 1037 kol., datë 18.7.2018, “Kontratë koncesionare e formës BOT (ndërtim, operim, transferim) për ndërtimin e hidrocentralit “Veleshicë””, është lidhur midis subjektit për qëllime të veçanta (SPV): “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në cilësinë e Autoritetit Kontraktues. Kjo kontratë ka një afat 35-vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. ka paraqitur edhe kontratën shtesë të koncesionit nr. 7 rep., nr. 3/2 kol., datë 3.1.2019, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim, operim, transferim), për ndërtimin e hidrocentralit ‘Veleshicë’”, të lidhur midis shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. dhe MIE-s.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, “Kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullësor publik për shtrirjen e tubacionit dhe të kanalit” për HEC “Veleshica 2”, me nr. 32 prot., datë 3.6.2019, të lidhur midis palëve: Bashkisë Kukës, në cilësinë e qiradhënësit dhe Shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për një afat 1-vjeçar (njëvjeçar), i cili fillon nga momenti i marrjes së lejes përfundimtare të ndërtimit me të drejtë rinovimi të afatit të saj.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, “Kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullësor publik”, me nr. 2077 prot., datë 28.3.2019, të lidhur midis palëve: Bashkisë Dibër, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për një afat 10-vjeçar (dhjetëvjeçar), i cili fillon nga data 27.3.2019–27.3.2029, më të drejtë rinovimi 3 muaj përpara përfundimit të afatit të saj.

- Shoqëria ka depozituar në ERE, “Raportin e oponencës teknike” nr. 7441/4 prot., datë 18.10.2018, mbi projektin e zbatimit të HEC-eve “Veleshicë 1 dhe Veleshicë 2” të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., miratuar nga MIE, me shkresën nr. 11068/3., prot., datë 27.12.2018.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. ka përcjellë në ERE marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit me nr. 531, datë 18.1.2019, të lidhur midis saj dhe shoqërisë OST sh.a., për HEC-et “Veleshica”.

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujqor”, me nr. 236 prot., datë 1.7.2019, të miratuar nga KBU Drin–Bunë, për shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. dhe “Leje për përdorim të burimit ujqor”, me nr. 236/1 prot., datë 1.7.2019, të miratuar nga KBU Drin–Bunë, për shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. Lejet janë lëshuar për secilën nga veprat e marrjes. Periudha e vlefshmërisë së tyre është në përputhje me kontratën e koncesionit.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, “Deklaratën mjedisore”, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 9750 prot., datë 7.12.2018, me nr. 948 identifikimi dhe nr. 57 vendimi, për personin juridik “Kalisi Hydropower” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ndërtim i HEC-eve ‘Veleshica 1’ dhe ‘Veleshica 2’”. Kjo deklaratë mjedisore është lëshuar respektivisht për kapacitetet e instaluar HEC “Veleshica 1” – 5801 kw dhe HEC “Veleshica 2” – 8116 kw, të cilat përkohë me “Kontratën e koncesionit dhe projektin e zbatimit”. Në këtë deklaratë citohet se zona në të cilën do të zhvillohet projekti, ndodhet jashtë zonave të mbrojtura dhe nuk prek asnjë monument natyre.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., rezulton se subjekti ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, ghermat “a”, “b”, “c”: plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, ghermat ghermat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;
- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, ghermat ghermat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, ghermat ghermat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;
- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, ghermat “a”, “b”, “c”: plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, ghermat ghermat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, plotësuar pjesërisht. Nuk janë depozituar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore për personin juridik dhe administratorin, të lëshuara nga prokuroria dhe Gjykata e Rrethit të Tiranës.
- Në zbatim të vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 127, datë 10.3.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe të shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, e më tej të vendimit nr. 128, datë 24.3.2020, “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe të shërbimeve gjyqësore

në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, të gjitha gjykatat në Shqipëri kanë marrë masa, duke përfshirë pezullimin apo reduktimin e aktiviteteve.

- Në kushtet e aktivitetit të kufizuar të Gjykatave në Republikën e Shqipërisë, sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kërkesës së “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të parashikuar në nenin 9, pika 2, germa “d”, brenda afateve rezultoi i pamundur.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1”, me kapacitet të instaluar 5801 kw, si dhe “Veleshica 2”, me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total 13917 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. *Shfuqizuar.*

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti